

Veli Veliu

RRETH FABULËS DHE MUNDËSITË E PËRHAPJES SË SAJ TE SHQIPTARËT

Fabula është njëra ndër krijimet më të hershme njerëzore. Në formën gojorë ajo paraqitet qysh në kohët më të lashta. Mirëpo edhe në formën e shkruar, të disa popuj indianë, arabë, grekë etj. ajo ekziston qysh prej antikës e ndoshta edhe më herët. Fabula është edhe një nga llojet letrare më të shpërndara në botë. Pothuajse nuk ka asnjë popull që nuk i ka këto tregime të shkurtra alegorike.¹ Fabula është mjaft prezente edhe te shqiptarët, si në formën gojore ashtu edhe në atë të shkruar. Në këtë të dytën, për shkak të kushteve historike, kulturore e tjera, paraqiten pak me vonesë në krahasim me shumë popuj të tjerë. Shumë nga këto fabula janë produkt i vetë popullit shqiptar, por ka edhe një numër që kanë depërtuar nga kulturat e popujve të tjerë. Kështu, në letërsinë gojore shqipe, ndeshim fabula me prejardhje nga gurra e Ezopit a fabula greke, nga ajo e La Fontenit, të popujve të ndryshëm orientalë etj. Meqë për praninë e këtij lloji letrar, si dhe për këtë fenomen të rëndësishëm të shqiptarët kemi bërë fjalë gjerësisht në një punim tjetër të botuar po në këtë revistë,² kësaj radhe vëmendjen do ta përqendrojmë në shtigjet e mundshëm të depërtimit të fabulës te shqiptarët.

1. Lashtësia e fabulës dhe interesimi për të

Origjina e përrallës popullore, duke përfshirë këtu edhe fabulën, ka qenë objekt interesimi i shumë shkencëtarëve. Si rezultat i një interesimi dhe përpjekjeje të tillë sot ekzistojnë shumë hipoteza, prej të cilave, sipas mendimit tonë, tri meritojnë tretman të veçantë: ajo migruese, mitologjike dhe antropologjike.

Siç e dimë, sipas të parës a hipotezës migruese, syzhetë a motivet e këtyre llojeve, të gjithë popujt, e kanë burimin ose rrjedhin

¹ La Fontaine: *Fables*. Annotées et commentées par Pierre Michel et Maurice Martin. Tome premier, Bordas, 1973, fq. 3.

² Dr. Veli Veliu: *Fabula shqipe në formën gojore*. Gjurmime albanologjike, seria-folklor dhe etnologji, nr. 12, 1982, fq 153—160.

nga letërsia e lashtë indiane. Ata janë shpërndarë nëpërmjet kontakteve të ndryshme në mes të popujve, kontakteve tregtare, luftarake, kulturore etj. Krijuesi i kësaj hipoteze është shkencëtari gjerman T. Benfey (1809—1881), i cili publikon një numër të madh tekstesh të vjetra indiane, e sidomos përmbledhjen kapitale „Pançatantra”. Sipas hipotezës mitologjike, krijues i së cilës janë vëllezërit gjermanë Jakob dhe Vilhem Grim, syzhetë a motivet homogjene janë rezultat i mitologjisë së përbashkët të popujve indoevropianë. Sipas hipotezës së tretë, syzhetë ose motivet homogjene a të ngjashme të popujve të ndryshëm janë rezultat i natyrës, psikologjisë dhe intelektit të njëjtë të njeriut dhe të kushteve identike a të ngjashme të zhvillimit të tij. Sipas kësaj, kur një popull arrin në një shkallë të determinuar të zhvillimit të tij social, ekonomik dhe kulturor, pavarësisht nga tjetri, tek ai paraqiten forma a motive të ndryshme të cilat mund të jenë homogjene ose të ngjashme me ato të popujve të tjerë. Në këtë mënyrë, kritikët dhe shkencëtarët anglezë E. B. Teylor (Primitive culture, 1871) dhe J. Frazer (The Golden Bough, 1890) dhe shumë themelues të tjerë të kësaj hipoteze i shpjegojnë syzhetë a motivet homogjene ose të ngjashme te popuj shumë të largët njëri nga tjetri, popuj që nuk kanë pasur asnjë kontakt, qoftë me Indinë ose me vende të tjera të kësaj tradite. Në esencën e tyre, secila nga këto hipoteza, siç shohim, ka të meta. Asnjëra nuk është në gjendje vetë ta zgjidhë këtë problem, por së bashku mund të ndihmojnë shumë dhe të japin rezultate të qëndrueshme.

Duke u bazuar në këto hipoteza, si dhe në shumë cilësi të fabulës, na mund të themi se shumë nga këto tregime të shkurtra alegorike janë rezultat i natyrës, i psikologjisë dhe i intelektit të njëjtë të njeriut dhe të kushteve identike a të ngjashme të zhvillimit të tij. Në këtë mënyrë besojmë se lindën edhe shumë fabula shqiptare, fabula që na i kemi pagëzuar autoktone, të cilat janë pjellë e këtij populli në hisotrinë mjaft të gjatë të ekzistimit të tij. Mirëpo, te shumë popuj, si edhe te shqiptarët, janë mjaft fabula që kanë depërtuar nga jashtë, nga popujt e tjerë, si rezultat i kontakteve të ndryshme të shumëllojshme direkte dhe indirekte. Siç dihet, kontakte të tilla a të ngjashme ka pasur (dhe ka) gjithmonë në mes të popujve. Për një depërtim të tillë duket se kanë ndihmuar edhe disa cilësi të vetë fabulës: karakteri popullor, ai personifikues-alegorik, mundësia e aludimit e të tjera.

Njerëzit, e sidomos masat e gjera popullore, nga natyra e duan të shprehurit alegorik ose me gjuhën e Ezopit (siç është bërë zakon të thuhet) për të shprehur ngjarjet a hallet e jetës së përditshme. Prandaj shumë cilësi të strukturës kompozicionale, të dialogut, të përfundimit etj. nuk dallojnë shumë nga fabulat e një populli prej atij tjetrit. Megjithatë, diku më tepër e diku më pak, ato ekzistojnë. Këto vërehen në elemente kombëtare që i bëjnë të dallohen nga ato të popujve të tjerë. Në këtë mënyrë, edhe ato fabula që depërtojnë nga popujt e tjerë bëhen pronë e atij populli që i përvetëson. Kështu ka ndodhur te shumë popuj po ashtu dhe te shqiptarët.

Fabula, në formën e saj gojore, daton qysh nga kohët më të lashta „qysh nga koha e njeriut primitiv, kur ai jetonte nga gjuetia dhe ishte në kontakt të pandërprerë me egërsirat”³ ose, nëse përdorim fjalët e Milivoj Sironiqit, origjina e saj korrespondon me kohën kur „njeriu ka jetuar në natyrë, krejtësisht i lirë dhe në kontakt të ngushtë me kafshët, të cilat i gjuante për nevojat e përditshme përpara se të kultivojë arat”.⁴ Ndërsa Pierre Michel dhe Maurice Martin për këtë thonë: „Do të ishte e kotë të kërkohet origjina e tyre nga historianët, sepse ajo ka të bëjë me fillimet e civilizimeve primitive”.⁵

Kështu, gjatë gjuetisë, njeriu ka pasur rastin t'i shohë dhe t'i njohë sjelljet dhe vetitë e ndryshme si edhe raportet e kafshëve, që janë mjaft të ngjashme me ato njerëzore. Ai e ka parë „luftën në mes të kafshëve të forta dhe të dobëta, në mes të kafshëve dinake dhe ato naive, luftën që i ngjante luftës së tij me armikun”.⁶ Në këtë mënyrë, nga këto sjellje a veti, njeriu filloi të krijojë tregimet e shkurtra alegorike, nga të cilat, më vonë, do të lindë fabula. Por kjo „më vonë” daton po ashtu nga kohët shumë të lashta. Me fjalë të tjera „fabula është ndarë nga tregimet e para për kafshët në atë kohë kur rrëfyeshi, me qëllim që të jetë i dobishëm, nxori nga tregimi i tij mësimin moral. Së këndejmi ideja mjaft e qëlluar për të krijuar nga vëllezërit tanë inferiorë, mjeshtër të urtësisë, ka ekzistuar te të gjithë popujt, posa ata kanë mësuar të gjykojnë a mendojnë për jetën dhe rregullat e sjelljes që ajo i përfshin”, thotë Emile Chambry.⁷ Duke u nisur nga kjo, mund të themi, me plot të drejtë se edhe te shqiptarët, në formën gojore, fabula është prezente qysh nga kohët më të lashta parahistorike.

Fabula në fillim është përhapur në formë gojore. Por më vonë, kur njerëzit fillojnë të merren me këtë lloj letrar, duke i përmbledhur ose shkruar, ajo përhapet dhe në letërsinë e shkruar. Njerëzit i lexojnë këto në libra të ndryshëm e mandej, nga goja në gojë, përhapen edhe në masa të gjera, në popull. Kështu kanë depërtuar shumë fabula të përmbledhjes së „Pançatantra” të Indisë, ato të Ezopit, La Fontenit etj. te shumë popuj si dhe te shqiptarët.

Siç thamë, fabula është prezente pothuajse te të gjithë popujt. Për shkak të lashtësisë së madhe dhe prezencës së saj në shumë popuj, sot është vështirë të thuhet me saktësi se në cilin vend paraqitet për herë të parë. Dihet se qysh herët ajo është kultivuar edhe në Indi. Shumë shkencëtarë pretendojnë ta paraqesin këtë vend si atdhe të parë të këtij lloji letrar.⁸ Siç dihet, India është vendi ku ka

³ Anton Çetta: *Prozë popullore nga Drenica*. Prishtinë, 1972, fq. 23.

⁴ Milivoj Sironić: *Zbornik esopovskih basana*. Zagreb, 1951 (Parathënie).

⁵ La Fontaine: *Fables... vep. e cit.* fq. 3.

⁶ Vojislav Đurić: *Antologija narodnih pripovedaka*. Novi Sad, 1960, fq. 10—11 (Parathënie).

⁷ Emile Chambry *Notice sur Esope*. — Në: *Esope: Fables*. Paris, 1927.

⁸ I këtij mendimi është, përveç të tjerëve, edhe shkencëtari Huet (1630—1721), shih Emile Chambry, *vep. e cit.* fq. XXIV.

lindur edhe një nga përmbledhjet më të hershme (e ndoshta edhe më e hershme), përmbledhja e lartpërmendur „Pançatantra”. Supozohet se është redaktuar kah shekulli X para erës sonë, në gjuhën sanskrite, nga njëfarë Viknon Sirma për t'i edukuar dy princat e rinj,⁹ mendim që kontestohet mjaft nga Benfey. Sipas këtij të fundit, këto fabula „vendosen me intervale prej shekullit II para erës sonë e deri në shekulin IV të erës sonë”.¹⁰ Sidoqoftë, këto fabula janë ndër më të lashtat, nëse jo më të lashtat në botë.

Në saje të kontakteve të ndryshme të popujve të këtij regjioni ose atij indian e tjerë, qysh herët këto tregime të shkurtra alegorike fillojnë të shpërndahen a të depërtojnë te shumë popuj të tjerë. Kështu, ata kalojnë së pari në Persi, kurse nëpërmjet persishtes ose persianëve edhe në botën arabe.¹¹ Nga popujt arabë ato kalojnë në ata hebrenj, grekë, latinë etj.¹² Nga këto fabula, sikurse edhe nga ato të përmbledhjes „Pançatantra” etj. janë bërë edhe përkëthime a kompilime të ndryshme. Një nga këto versione është pa dyshim edhe ajo e Pilpejit ose Bidpejit, brahmanit legjendar ose „indianit të urtë”, siç e quan La Fonteni.¹³ Nga edicionet e ndryshme të kësaj përmbledhjeje të vjetër që ka vend të posaçëm është ajo e Benfey (Paris, 1858). Mirëpo shkencëtarët e konsiderojnë Greqinë si djep të fabulës. Këtu mendohet menjëherë në Ezopin, i cili konsiderohet si themelues i fabulës greke.

Greqia është shumë e pasur me këto tregime të shkurtra alegorike që kanë një traditë të gjatë bile edhe në formën e shkruar. Pra, edhe në këtë formë ajo paraqitet qysh herët. Kështu, qysh kah shekulli VIII para erës sonë Heziodi e shndërroi në vargje fabulën „Bilbili dhe gjeraqina” e cila konsiderohet „fabula më e vjetër që na është e ruajtur”.¹⁴ Në shekujt që vijojnë hasim po ashtu në fragmente fabulash ose dokumente mbi fabulat e Arkilokut, Semonidit të Amorgës dhe të Stezikorit.¹⁵ Sido që të jetë, këta dy shekuj paraqesin vetëm fillimin e ekzistencës së tëtij zhanri (në formë të shkruar) në këtë vend. Sepse, vetëm në shekullin VI fillon epoka e poezisë gnomike. Kjo është koha kur Shtatë të Urtët i përmbledhin, në formë maksimash, vërejtjet e tyre ndaj sjelljeve të njerëzve, kur Pitagora dhe nxënësit e tij i reduktojnë dituritë e tyre në porosi a recepte, kur Kleobili i Lindos dhe vajza e tij i paraqesin enigmat e tyre. Kjo është koha gjithashtu kur tradita e paraqet Ezopin ose kur „shpirtrat janë të kthyer nga morali ose fabula duhej të lulëzonte dhe të sillte fryte”.¹⁶ Thuhet „tradita e paraqet Ezopin” sepse, për shkak të mungesës së dokumenteve autentike, dyshohet se ai është trilluesi a krijuesi

⁹ René Bray: *Les Fables de La Fontaine*, Paris, 1929, fq. 17.

¹⁰ Emile Chambry, *vep. e cit.* fq. XVI.

¹¹ *Les Fables de Pilpay philosophe indien, ou la Conduite des Rois*. Paris, 1698 (Parathënie).

¹² René Bray: *vep. e cit.* fq. 28.

¹³ La Fontaine: *Oeuvres complètes* (Parathënie). Paris, 1965, fq. 117.

¹⁴ Emile Chambry, *vep. e cit.* fq. XXII.

¹⁵ *Aty*, fq. XXII—XXIII.

¹⁶ *Aty*, fq. XXXIII.

i fabulës greke që atij i atribuohet. Është e mundshme që këto fabula të jenë të njërit apo më shumë krijuesve ose ndoshta fryt i popullit në përgjithësi. Kështu themi sepse e dimë se „grekët kanë dashur që për çdo krijim të kenë edhe krijuesin, nga është e mundshme që edhe krijimin e fabulës t'ia kenë atribuar Ezopit”.¹⁷ Në favor të këtij konstatimi flet edhe fakti se atij i kontribuohen edhe fabula që tanimë u dihet autori.¹⁸ Nuk dihet me saktësi se a ka ekzistuar apo jo ky fabulist grek. Sipas dokumenteve dhe dëshmimeve të historianëve, filozofëve dhe shkrimtarëve të ndryshëm si Herodoti, Herakliti, Aristofani, Plutarku e të tjerë, supozohet se ai ka jetuar në shekullin VI para erës sonë (570—536), se ka lindur në Frizhi, ka shërbyer gjatë kohës si skllav te disa skllavopronarë para se të shpëtojë nga skllavëria me sjelljen dhe virtutet e larta të tij.¹⁹ Për shkak të mungesës së dokumenteve autentike me emrin e tij janë lidhur shumë legjenda, tregime a anekdota të cilat dëshmojnë, përveç tjerash, edhe për interesimin e madh të grekëve ndaj këtij lloji letrar. Dhe nëse e zëmë se Ezopi është autor i këtyre fabulave, na ngel diskutabile çështja tjetër mjaft me rëndësi: a i ka përhapur ato në formë gojore apo të shkruar? Për këtë mendimet janë të ndara. Disa mendojnë se ky fabulist „nuk i ka shkruar fabulat e tij, por i ka treguar gojarisht në prozë”.²⁰ Më në fund, sido që të jetë, Ezopi nuk është i vetmi fabulist i kohës së vet. Gjatë këtij shekulli dhe më vonë kemi edhe shumë fabulistë të tjerë si Ksenofoni, Platoni dhe Teopompi (shekulli VI) dhe Demetrios nga Falezi, Teofrasti, Aristoteli, Plutarku, Babriusi, Lusieni e të tjerë të shekujve të mëvonshëm,²¹ gjë që dëshmon traditën e gjatë të këtij zhanri letrar në antikën greke.

Qysh herët fabula është kultivuar dhe në shumë vende e popuj të Azisë dhe të Afrikës Mesdhetare. Kështu, përmenden fabulat libike, koriane, egjiptiane, kipriane, siboritike, frizhiane etj., të cilat nga disa shkencëtarë konsiderohen si fabula origjinale, kurse nga të tjerë ato dallojë vetëm për nga emri prej atyre të Ezopit.²²

Këto fabula ose pjesa më e madhe e tyre, sikurse edhe ato indiane, nëpërmjet kontakteve të ndryshme, kalojnë në shumë vende të tjera dhe, siç do të shohim më vonë, disa prej tyre do të kalojnë edhe te shqiptarët. Kështu, nëpërmjet kontakteve e sidomos nga përkthyesit a kompiluesit e ndryshëm, ato kalojnë qysh herët edhe në anën tjetër të Adriatikut, në Siujdhesën Apenine, në gjuhën latine dhe nëpërmjet saj edhe në shumë vende të tjera të Evropës dhe gjetiu. Në këtë pikëpamje ndihmon sidomos Fedri (shekulli i parë i erës sonë), fabulist i famshëm romak, „mjeshtër i fabulave antike”²³

¹⁷ Miloš N. Đurić: *O Ezopu i njegovim basnama*. — Në: *Ezop: Basne* (Parathënie), Beograd, 1965, fq. 7.

¹⁸ Morten Nojgaard: *Fables antiques*. Tome premier, Kopenhavn, 1964, fq. 454—475.

¹⁹ Emile Chambry, *vep. e cit.* fq. XXIX.

²⁰ Milivoj Sironić, *vep. e cit.* (Psthënie).

²¹ Emile Chambry, *vep. e cit.* fq. XXX—XXXIII.

²² *Aty*, fq. XXII.

²³ Morten Nojgaard, *vep. e cit.* tome 2, fq. 17.

ose mjeshtri i vargut, i cili, edhe pse i huazoi syzhetë nga Ezopi e të tjerë, krijoi një vepër plotësisht origjinale.²⁴ Duke dashur t'ua përshtasë fabulën kushteve politike dhe sociale të shoqërisë së kohës së tij,²⁵ ai, në të shumtën e rasteve, e ndryshoi qoftë formën, qoftë përmbajtjen e fabulës greke që e imiton.

Përkundër punës së tij, gjatë Mesjetës, Fedri ngel krejtësisht i harruar. Nga fundi i epokës antike, fabulat e tij përkthehen në prozë dhe, bashkë me fabula të tjera, formojnë një përmbledhje, e cila nuk do të mbajë emrin e autorit të vërtetë, por të njëfarë kompiluesi me emrin Romulus. Me këtë emër këto fabula do të përkthehen, redaktohen ose ndryshohen nga shumë përkthyes a kompilues të tjerë gjatë gjithë Mesjetës në shumë vende të Evropës Perëndimore e gjetiu. Kështu u desh të vijë Renesansa ose, më vonë Klasicizmi, koha kur njerëzit interesohen për çdo gjë të antikës që të mund të zbulohet përsëri ose të rehabilitohet dhe të marrë vendin e merituar në letërsi. Sidoqoftë, edhe në këtë mënyrë fabulat e tij u përhapën mjaft nëpër popuj të ndryshëm të Evropës dhe më gjerë.

Përkundrejt Fedrit, Ezopi ngeli gjithmonë i njohur. Fabulat e tij, edhe gjatë Mesjetës dhe më vonë, ngelën të njohura dhe mjaft të popullarizuara, dhe në këtë mënyrë ato u shpërndanë, nëpërmjet kontakteve, përkthimeve a kompilimeve, gati në gjithë botën. Kur është fjala për përkthyes a kompilues gjatë Mesjetës, po përmendim edhe Abstemius, Avianus, Nevelet, Halma, Planud, Faerno e të tjerë.

Qysh herët fabula është adhuruar dhe kultivuar edhe në Francë. Në saje poashtu të kontakteve të ndryshme në mes të popujve, edhe këtu, si dhe gjetiu, arrijnë shumë fabula nga vende të ndryshme evropiane, e sidomos nga Italia. Megjithatë, ajo këtu arriti lulëzimin më të madh gjatë Mesjetës, atëherë kur shumë përkthyes a kompilues edhe fabulistë të vërtetë, u morën me këtë lloj letrar. Fakti që disa fabulistë (si Marie de France, për shembull) i quajnë fabulat e tyre „Isopets”, flet shumë për famën e fabulës së Ezopit edhe në këtë vend. Interesimi ngel gati i njëjtë edhe gjatë Renesansës. Gjatë kësaj kohe, humanistë të ndryshëm fillojnë ta rimojnë veprën e Ezopit, të Fedrit dhe të të tjerëve. Në këtë punë dallohet sidomos Marot dhe Regnier, të cilët konsiderohen si paraardhës të La Fontenit.

Në zhvillimin e saj të mëtejshëm në këtë vend kontribuoi mjaft La Fonteni, fabulat e të cilit u bënë shembull klasik për fabulistët e ardhshëm frëng, evropianë etj. Gjatë kësaj kohe ose gjatë epokës së klasicizmit frëng, me fabulën u morën edhe të tjerë si Fénelon, Perrault, Benséradé e të tjerë. Por, nga të gjithë këta La Fonteni u gjind më së miri në këtë punë. Ai i hodhi në hije paraardhësit, bashkëkohësit si dhe pasardhësit e tij, dhe në këtë mënyrë bëhet i famshëm jo vetëm në Francë, por edhe jashtë kufijve të saj. Forma e re e fabulës së tij, përkundrejt rezistencës së Lesingut, bëhet model për gati gjithë fabulistët bashkëkohorë dhe të ardhshëm të Evropës

²⁴ A. Brenot: *Introduction*. — Në: Phèdre: *Fables*. Paris, 1923, fq. IX—XVI.

²⁵ Morten Nojgaard, *vep. e cit.* Tom 2, fq. 173—191.

e më gjerë. Prandaj sot me të drejtë flitet për praninë dhe influencën e këtij fabulisti të madh frëng në Spanjë, e sidomos te fabulistët si Samaniego dhe Iriat, të cilët e përkthejnë, e adaptojnë ose e imitojnë me të madhe;²⁶ në Hungari te Peszeli, i cili i „zhvendos fabulat e La Fontenit duke ua aplikuar Hungarisë së kohës; te Versghi, i cili „i zgjedh fabulat që paraqesin jetën e popullit” etj.;²⁷ në Poloni ku qysh herët ndërpritet tradita latine për t’u orientuar nga Franca, ku La Fonteni gjen disa adhurues dhe imitues, poetë të famshëm si Frembecki, Mickieviç, Korecki e të tjerë;²⁸ në Rusi ku shumë fabulistë si Sumorakov, Izmailov, Dimitriev e sidomos Krilovi e ndjekin për së afërmi fabulistin e madh frëng; në Jugosllavi ku gjen, përveç të tjerëve, fabulistin e madh Dositej Obradoviçi; te shqiptarët Naimi, Çajupi, Negovani, Mjedja e të tjerë.²⁹

2. Mundsitë e kontakteve me shqiptarët

Siç përmendëm, përveç fabulave që i konsiderojmë autoktone shqiptare, disa motive a fabula janë me origjinë të ndryshme: greke a ezopike, nga fabulat e La Fontenit, fabula orientale, latine e të tjera. Si kanë depërtuar në këtë popull?

Si te shumë popuj të tjerë që përmendëm, ashtu edhe te shqiptarët, ato depërtuan nëpërmjet kontakteve të ndryshme të këtij populli me të tjerë. E këto kontakte, siç do të shohim, qenë direkte dhe indirekte të shumëllojshme, kontakte kulturore, tregtare, nëpërmjet arsimit etj. Këtë mund ta kuptojmë më së miri kur dime se ky popull i vjetër i Ballkanit ka jetuar (dhe jeton) në udhëkryqin e rrugëve të ndryshme, në këtë pjesë të botës që ka pasur një të kaluar të bujshme me plot luftëra dhe ndeshje të qytetërimeve të ndryshme. Dimë se shqiptarët kanë jetuar qysh nga kohët më të lashta në fqinjësi (e shpeshherë nën zgjedhën) e popujve si grekët e romakët ku, siç e pamë, ky lloj letrar është kultivuar me të madhe qysh herët. Pra, shtigjet e depërtimit të fabulave ose të motiveve të ndryshme te shqiptarët janë të shumta dhe të llojllojshme. Ne do të përpiqemi të paraqesim ata më kryesoret ose ato që, sipas mendimit tonë, kanë qenë më të frytshme.

a. Kontaktet greko-shqiptare

Fqinjësia e këtyre dy popujve daton qysh nga koha kur ata vendosen në këtë pjesë të kontinentit të vjetër. Shqiptarët a para-

²⁶ Shih Julien Garawito: *La Fontaine en terre hispanique. Europe, revue mensuelle*. Paris, Mars 1972, fq. 146—148.

²⁷ Dénes Lenguel: *La Fontaine en Hongrie. Europe, vep, e cit.* fq. 148—155.

²⁸ Marjan Deszcz: *La Fontaine i jęgo wpliw na bajke Polske*. Krakowie, 1921, fq. 2—24.

²⁹ Dr. Veli Veliu: *La Fontaine chez les Albanais* (tezë dokto-
nature). Dijon, 1981.

ardhësit e tyre — ilirët këtu jetojnë qysh kur jetojnë edhe grekët.³⁰ Qysh prej kësaj kohe, si një nga popujt më të mëdhenj të kohës, ata vendosen në territor shumë më të madh që shtrihej nga Veriu, deri në Danub, nga Lindja, Vardari dhe Morava, nga Jugu deri në limanin Ambrasia dhe nga Perëndimi, Deti Adriatik,³¹ pra, në mes të Adriatikut dhe Pellgut Panonian ose në mes të botës greke dhe asaj të Evropës Qendrore, në udhëkryqin e rrugëve të ndryshme tregtare, kulturore e të tjera. „Qysh në neolit e kështu edhe në epokat e vonshme parahistorike dhe historike, Ballkani ishte i përshkuar prej tregtarëve, të cilët, natyrisht, përveç që transportojshin mallërat e tyre, ushtrojnë një ndikim shumë të madh në përhapjen e të mbërri-meve kulturore”, thotë Aleksandër Stipçeviqi.³² Cilët janë këta tregtarë e të tjerë? Këta janë popuj të ndryshëm të Evropës e më gjerë të kohës, sidomos grekët.

Qysh herët, një numër mjaft i madh ilirësh vendosin ta lidhin fatin e tyre përgjithmonë me këtë fqinjë të Jugut, duke depërtuar a duke u vendosur në shumë pjesë të territoreve të tyre. Siç dihet, një fenomen i tillë migrimi përsëritet me të madhe edhe gjatë mesjetës, gjë që ka ndikuar që sot të hasim me të madhe elementin shqiptar në këtë pjesë të Greqisë. Nga ana tjetër, kah mesi i shekullit VIII para erës sonë, përkundër rezistencës së popullatës, nëpër viset bregdetare ilire, fillojnë të formohen koloni greke.³³ Më vonë, kur armiqtë mbarojnë „marrëdhëniet tregtare ndërmjet kolonizatorëve dhe fiseve ilire, me kohë janë bërë shumë të mira e të frytshme dhe patën si pasojë lulëzimin e shpejtë të vetë kolonive, në një anë e, në anën tjetër, zhvillimi ekonomik dhe shoqror të fiseve ilire që kontaktojnë grek”.³⁴ Por kontaktet nuk u kufizuan vetëm me krahinat bregdetare. Nëpërmjet rrugëve të ndryshme, e sidomos nëpërmjet atyre që kalojnë nëpër Luginën e Vardarit, Moravës dhe Danubit, grekët vijnë në kontakte të shpeshta edhe me ilirët e brendisë së vendit të tyre. Natyrisht këta të fundit, si marinarë dhe tregtarë të mirë, i shkelin gjithmonë viset greke. „Në këtë mënyrë, siç thotë E. Çabej, marrëdhëniet herë luftarake, herë paqësore nuk kanë përshtuar kurrë midis këtyre dy popujve”.³⁵

Nëpërmjet këtyre kontakteve, qysh herët, shumë elemente të kulturës greke depërtojnë në atë ilire dhe anasjelltas. Gjithë kjo bëhet edhe më e theksuar pas nënshtrimit të kësaj popullate nga ana e romakëve, e sidomos pas ndarjes së Perandorisë romake në atë të Lindjes dhe të Perëndimit. Duke ngelur, pjesa më e madhe, nën sundimin e Perandorisë së Lindjes a Bizantisë, ilirët vazhdojnë të

³⁰ Shih edhe Alojz Benac: *Mbi proceset etnogjetike dhe përcaktimi i kufijve tokësorë të fiseve ilire*. Studime ilire. Prishtinë, 1978.

³¹ *Historia e popullit shqiptar I*, Prishtinë, 1969, fq. 44—48.

³² Aleksandar Stipçeviq: *Ilirët*. Prishtinë, 1967, fq. 115—116.

³³ Eqrem Çabej: *Huazime greke*. — Në: Eqrem Çabej: *Studime gjuhësore*, vol. 3. Prishtinë, 1976, fq. 46.

³⁴ *Historia e popullit shqiptar I*, vep. e cit. fq. 54—67.

³⁵ Eqrem Çabej, vep. e cit. fq. 46.

mbajnë lidhje, dhe tani edhe më të ngushta dhe të shumëllojshme, me grekët, inspiratat ekspansioniste të të cilëve shtohen edhe më tepër në dëm të popujve që gjenden nën sundimin e tyre. Për t'i nënshtruar ose asimiluar, ata përdorin mjete të ndryshme, e sidomos kishën dhe shkollat. Që në të dyjat tanimë përdoret greqishtja, e cila, duke e zëvendësuar latinishten, bëhet gjuhë zyrtare në gjithë Perandorinë. Kështu, të ndihmuar nga kleri dhe kisha, qysh nga këto kohë, grekët fillojnë të hapin shkolla në gjuhën greke nëpër viset shqiptare, ku shumë njerëz të arsimuar mirë vijnë në këto vise për t'u dhënë mësim a për të propaganduar religjionin dhe kulturën greke.

Situata nuk ndryshon edhe pas rënies së Konstantinopolit në duart turke ose shkatërrimit të Perandorisë Bizantine. Pas një kohe, pasi moralisht dhe materialisht shërohet deri diku, Greqia vazhdon edhe më me forcë politikën e vjetër, duke përdorur kishën dhe shkollën si instrumente më të përshtatshme. Situata bëhet edhe më e qartë në shekullin XVIII, sidomos në atë që vijon, atëherë kur ky fqinjë i popullit shqiptar përpiqet në çdo mënyrë t'i plotësojë apetitet ekspansioniste permanente ose ta realizojë „Megali idhenë” e tij.³⁶

Kështu, gjithkund në Shqipëri, sidomos në atë të Jugut (ku pjesa më e madhe e shqiptarëve kishte pranuar religjionin ortodoks) autoritetet politike, nëpërmjet kishës, vazhdojnë me të madhe të hapin shkolla të reja, ku greqishtja ngel edhe mëtutje gjuha e shkencës dhe e kulturës. Dhe jo vetëm ajo, por edhe vetë tregtia e ndërron karakterin duke u zhvilluar dhe orientuar sa më tepër nga Greqia. Me një fjalë, të gjitha përpjekjet koncentrohen në popullatën shqiptare me qëllim shumë të thjeshtë — ta asimilojë dhe ta tregojë para botës si greke. Nëpër shkollat mësohet letërsia greke, flitet për shkrimtarë a filozofë grekë, e ndër ata sigurisht edhe për Ezopin. Pa dyshim, lexohen, analizohen a mësohen përmendsh shumë fabula të këtij fabulisti grek, i cili ngel gjithmonë aktual në këtë vend. Natyrisht, në këto rrethana a kushte nxënësit shqiptarë e mësojnë mirë greqishten. Në këtë gjuhë ata i fitojnë edhe dituritë e para të tyre të organizuar. Në këto shkolla, siç e dimë, i fitojnë dituritë e para edhe shkrimtarët si Çajupi, Negovani, Kristo Floqi e të tjerë. Pa dyshim, në këto shkolla ata për herë të parë janë njohur edhe me fabulën greke. Prandaj, nuk duhet të na habitë fakti që disa fabula, me prejardhje nga Ezopi, janë prezente ndër shqiptarët. Pa dyshim, kësaj gjendjeje i kanë kontribuar mjaft edhe shkrimtarët si Negovani, Naimi, Kristo Floqi e të tjerë.

Nëpërmjet këtyre kontakteve nuk kanë depërtuar vetëm këto fabula. Përveç tjerash, nëpërmjet Greqisë kanë depërtuar edhe fabula të La Fontenit. Siç dihet, Greqia ka qenë gati gjithmonë në qendër të interesimit të Evropës Perëndimore. Interesimi gjatë Rilindjes evropiane dhe Klasicizmit, siç e dimë, arrin në një shkallë shumë të lartë. Ai vazhdon edhe shumë kohë më vonë si edhe sot. Nga ana tjetër, grekët po ashtu interesohen për këtë pjesë të botës,

³⁶ Sami Frashëri: *Shqipëria çka qenë, ç'është e çdo të bëhetë*. Tiranë, 1962, fq. 47—48.

e sidomos për Francën. Në shekullin XVIII, e sidomos në atë që vijon, kontaktet në mes të këtij vendi dhe vendeve të Evropës Perëndimore bëhen edhe më të dendura dhe më të llojlojshme. Gjatë rilindjes, shumë grekë të rinj shkojnë në Francë ose në Itali për të studiuar, ku njihen me kulturën frënge (e cila është mjaft në modë)³⁷ dhe përveç tjerash me fabulën e La Fontenit. Një pjesë e madhe e tyre, pas kthyerjes në vend, punojnë si arsimtarë në shkollat greke që akoma (për shkak të rrethanave të ndryshme) i vijonin edhe nxënësit shqiptarë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që i njohin me kulturën frëngë, por edhe me fabulat e La Fontenit.

b. Kontaktet e shqiptarëve me romakët dhe italianët

Përveç grekëve, qysh herët shqiptarët kanë qenë në kontakt direkt dhe indirekt edhe me fqinjin e anës tjetër të detit, romakët ose më vonë italianët. Kontaktet kanë qenë të llojlojshme: ekonomike, politike, kulturore e të tjera. Romakët, sidomos tregtarët, gjejnë rrugë të ndryshme për të përshkuar gati tërë Ilirinë e kësaj kohe. E e njëjta gjë ndodhte edhe me ilirët. Shumë rrugë, e sidomos ajo e „Via Egnatia”, krijojnë nga ky vend njëlloj ure në mes të Romës dhe Lindjes së Afërme, ose më vonë Konstantinopolit.³⁸ Megjithatë, këto kontakte janë më të shumta në viset bregdetare, atje ku, qysh në të kaluarën e largët, janë ndeshur interesat e shumë popujve. Më vonë, pas pushtimit të tërë Ilirisë nga romakët, këto kontakte janë bërë edhe më direkte dhe të llojlojshme. Kjo është koha kur fillon një epokë e re në historinë e ilirëve, periodë e cila zgjat dhjetë shekuj, kohë kur ky popull gjendet në sprovat më të mëdha, në rrezikun që të asimilohet a të romanizohet plotësisht, siç ishte rasti me disa popuj tjerë.

Në këtë epokë kultura romake, me të gjitha llojet edhe pasurinë, depërton me të madhe te ky popull. Latinishtja gjithnjë e më tepër vjen duke e zëvendësuar ilirishten dhe kristianizmi religjionin e vjetër ilir. Megjithatë, „ndikimi i kulturës romake nuk i kaloi shumë kufinj të qyteteve dhe zonave fushore. Shtresat e gjëra të popullsisë së krahinave të brendshme, jo vetëm që nuk e përvetsonin aq lehtë këtë kulturë, por, përkundrazi, i bënë asaj një qëndresë të fortë që çfaqej në ruajtjen e gjallë të shumë zakoneve, të një tok shprehjesh artistike, të veshjeve, të gjuhës etj.”³⁹ Roma nuk i ndërpret këto kontakte a lidhje me këtë popull (e sidomos me atë të pjesës së Veriut, që tanimë e kishin pranuar katolicizmin) edhe pas ndarjes së Perandorisë në atë të Lindjes dhe të Perëndimit.

Më vonë, gjatë mesjetës, këto kontakte (e sidomos ato në lëmin e kulturës) me Italinë pasurohen mjaft. Kjo kulturë ose influencë

³⁷ *Histori e popullit shqiptar II, vep. e cit. fq. 39.*

³⁸ *Histori e popullit shqiptar I, vep. e cit. fq. 111 dhe 127.*

³⁹ *Aty, fq. 120—121.*

kulturore depërton te shqiptarët nëpërmjet shtigjeve të ndryshme, e sidomos nga njerëzit e klerit katolik, misionarë, priftërinj e të tjerë, njerëz të shkolluar, të cilët, në të shumtën e rasteve, këtu luajnë rolin e arsimtarëve. Në këtë kohë e sidomos prej shekullit XVI, në mesin e këtyre njerëzve, kishte edhe shqiptarë. Pas mbarimit të studimeve në universitet a në shkollat e ndryshme të Italisë, këta, si edhe kolegët e tyre italianë, punojnë në shumë shkolla katolike ose si priftërinj nëpër kisha. Për të pasur më shumë sukses ose për t'u kuptuar më mirë nga shtresat më të gjera popullore, ata fillojnë të përkthejnë libra të ndryshëm nga latinishtja a italishtja në shqipe ose të shkruajnë në këtë gjuhë edhe vepra origjinale.⁴⁰ Siç e dimë, nga këta njerëz janë edhe shkrimtarët e mirënjohur Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani e të tjerë.

Në shekullin XVIII, e sidomos në atë që vijon ose gjatë periudhës së Rilindjes kombëtare, lidhjet në mes të këtyre dy popujve bëhen edhe më të dendura dhe më të llojllojshme. Përveç tjerash, një situatë të tillë i kontribuojnë edhe arbreshët, të cilët nuk e harrojnë dhe, në këtë mënyrë, nuk i shkëpusin lidhjet asnjëherë me atdheun e tyre të vjetër, atdheun „m'at anë detit", siç kanë zakon ta quajnë.⁴¹ Gjatë kësaj kohe, shumë shkrimtarë si De Rada, Gavril Dara, Zef Serembe e të tjerë mbajnë një korrespondencë mjaft të dendur me kolegët, bashkëvendësit e tyre si Sami Frashërin, Jubanin, Mitkuan, Naimin etj. Siç e dimë nga këta shkrimtarë (F. A. Santori) na e kemi edhe përmbledhjen „Një kint përrallëza...".

Pa dyshim se nëpërmjet këtyre kontakteve e të tjera disa fabula të Ezopit, Fedrit dhe fabulistëve e tjerë kanë kaluar te shqiptarët. Sepse, siç përmendëm, edhe te ky fqinjë (në Itali) fabula është kultivuar me të madhe dhe ka traditë mjaft të gjatë. Sigurisht, nëpërmjet këtyre kontakteve kanë depërtuar edhe disa fabula të La Fontenit. Siç dihet, edhe Italia ka pasur gjithmonë marrëdhënie dhe kontakte të shumta dhe të llojllojshme në shumë lëmenj të jetës, e sidomos të kulturës me Francën. Prandaj ajo që ndodh në Francë është e njohur edhe në Itali dhe anasjelltas. Kështu, në shekullin XVIII, e sidomos gjatë epokës së Rilindjes shqiptare, Italia shndërrohet në njëfarë ure e depërtimit të ideve të ndryshme përparimtare frënge në Shqipëri, e bashkë me ta edhe fabulat e La Fontenit.

c. Kontaktet shqiptaro-frënge

Në krahasim me këta dy popuj fqinjë, kontaktet a marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe francezëve, deri në shekullin XVIII ose atë që vijon, nuk kanë qenë aq të mëdha dhe aq të llojllojshme. Rrethanat historike, e sidomos largësia gjeografike, kanë ndikuar

⁴⁰ Jashar Rexhepagiq: *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollos të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*. Prishtinë, 1970, fq. 53.

⁴¹ Shih A. Shkura: *Gli Albanesi in Italia*. Boston, 1912.

mjaft në këtë pikëpamje. Megjithatë, kontaktet, qoftë direkte apo indirekte, datojnë relativisht qysh herët. Kontakti i parë masiv direkt daton kah viti 1096, në kohën kur dy ekspedita kryqëzatash frënge, njëra nga Provansa e tjetra nga Flandra dhe Normandia, ia mësyen Shqipërisë në rrugë për në Lindjen e Afërt. E para e udhëhequr nga Raymond de Toulouse, pasi kalon „Normandinë, Istrinë dhe Dalmacinë”⁴² hyn në Shqipëri, nëpër Shkodër, kurse e dyta, pasi e kalon Italinë, nga Deti Adriatik zbarkon në Durrës. Që të dyja ekspeditat, pas disa ditëve, e vazhdojnë rrugën nëpër Luginën e Shkumbinit dhe Rrugën mbretërore, siç thirrej rruga e vjetër Via Egnatia,⁴³ duke u furnizuar me ushqim dhe udhërrëfyes nga banorët e këtyre viseve.

Mirëpo, gjatë Mesjetës ekzistojnë edhe kontakte të tjera, të cilat janë ndoshta edhe më të mëdha dhe më intime. Dhe kur e themi këtë, ne mendojnë, në kontaktet e shqiptarëve të emigruar në Peloponez dhe në krahina të tjera të Greqisë, të cilat, gjatë kësaj kohe, ishin nën sundimin frëng⁴⁴ dhe në ato të Sicilisë dhe të Korzikës etj.

Në kontakte më të dendura dhe më të llojlojshme hasim më vonë. Me disfatën e Austrisë dhe Paqen e Kampio Formio, më 1797, Franca e zëvendëson e Venedikun në Ishujt e Jonit, Korfuzit dhe të viseve të tjera bregdetare të Shqipërisë së Jugut ose të Shqipërisë Venedikase, siç thirrej akoma. Siç dihet, me disa ndërprerje, Franca këtu mbetet deri më 1914 ose në vitin e rënies së parë të Napoleonit I. Dhe meqë francezët politikisht gati asgjë nuk i sollën kësaj popullate, kjo i pranoi mjaft ngrohtë dhe bile edhe si çlirimtarë.⁴⁵ Jehona e Revolucionit të madh borgjez frëng që kishte ushtuar aq fuqishëm në vendet ballkanike nuk i la m'anësh edhe këto vise. Kështu, shqiptarët e këtyre krahinave, si dhe të tjerët, në këta njerëz shikojnë vendin e lirisë, vëllazërimit dhe barazisë, tri fjalët aq ekspresive dhe tinglluese për këtë popull që me shekuj ishte duke jetuar në robëri. Kjo Francë e Napoleonit, simbol i guximit dhe lirisë, krijoi për një kohë marrëdhënie mjaft të ngushta dhe miqësore në mes të këtyre dy popujve.⁴⁶

Gjatë kësaj kohe Franca hap edhe një konsulatë në kryeqytetin e Ali Pashë Tepelenës, në Janinë, ku, si konsul frëng, shumë vjet punoi Pouqueville, i cili ka lënë shumë shënime udhëtimi dhe mendime të ndryshme për Shqipërinë dhe shqiptarët.⁴⁷ Por, prania e Francës në këtë kohë nuk ndihet vetëm në këto vise. Ajo, diku më

⁴² Jovan Zujović: *L'influence intellectuelle française sur les Serbes*. Conférence faite à Paris le 8 Mars 1918, fq. 9—13.

⁴³ *Historia e popullit shqiptar I*, vep. e cit. fq. 167—168.

⁴⁴ Eqrem Çabej, vep. e cit. fq. 58.

⁴⁵ Sabri Godo: *Ali Pashë Tepelena*. Prishtinë, fq. 99.

⁴⁶ *Aty*, fq. 102.

⁴⁷ Pouqueville: *Voyage en Grèce I*, Paris, 1826.

tepër e diku më pak, ndihet gjithkund nëpër viset e banuara me shqiptarë si dhe gjetiu në Ballkan. Për të realizuar politikën e saj orientale, Napoleoni tregon interesim të madh ndaj vendeve ballkanike, interesim nga shumë aspekte e sidomos politike dhe tregtare. Kështu, si gjithkund në Ballkan, nëpër Shqipëri fillojnë të enden njerëz politikë, shkencëtarë dhe tregtarë, të cilët, në të shumtën e rasteve, marrin shënime të ndryshme udhëtimi në lidhje me shqiptarët dhe shqipërinë. Me prezencën e francezëve në Ujdhesat e Jonit, Korfuzit dhe në viset e tjera bregdetare të Shqipërisë dhe, më vonë, me formimin e Provincave Ilire (1809—1814) këto kontakte bëhen edhe më të shprehura, të shumëllojshme dhe të ngushta. Luftërat e pandërprera në mes të Francës dhe Anglisë e shtojnë edhe më tepër interesimin e Napoleonit ndaj Ballkanit.

Për shkak se rruga detare, e sidomos nëpërmjet Detit Mesdhe për në Lindjen e Afërt dhe Indinë, bëhet jo fort e sigurtë, perandori frëng orientohet nga brendia e Siujdhesës Ballkanike. Ai vendos të hapë një rrugë tokësore, rrugë që do të nisej nga Provincat Iliriane për në jug, duke kaluar nëpër Bosnë për të arrijtur në Prishtinë, ku duhej të ndahej në dy degë: një do të kthehej nga Lindja, duke kaluar nëpër Bullgari për të arrijtur në Stamboll, kurse tjetra do të vazhdonte nga Jugu, duke kaluar nëpër Shkup dhe Selanik, për t'u bashkuar me të parën në kryeqytetin turk, e prej këtu do të vazhdonte në Lindjen e Afërt dhe në Indi. Është interesant të thuhet se për shkak të kësaj ndërmarrjeje, më 1911, Napoleoni vendos të hapë në Prishtinë një përfaqësi diplomatike në rang të nënkonsulatis.⁴⁸

Këto e rrethanat e tjera ndikojnë që populli shqiptar të interesohej edhe më tepër për Francën ose, më mirë të themi, për gjithçka që është e re në këtë vend. Të frymëzuar nga idetë e reja revolucionare, shumë shqiptarë të rinj dhe të tjerë shkojnë në Paris si studentë, tregtarë ose punëtorë.⁴⁹ Kështu, idetë përparimtare frënge të shekullit XVII dhe XVIII tanimë janë pothuajse gjithkund prezente. Qytetet si Janina, Voskopoja, Shkodra dhe shumë të tjera bëhen vatrat më të rëndësishme të përhapjes së këtyre ideve përparimtare frënge.⁵⁰ „Me marrëdhëniet me Evropën Perëndimore e institucionet arsimore-kulturore të tyre hynë në Shqipëri vepra e doktrina shkrimtarësh a filozofësh të shekujve XVII—XVIII, depërtuan idetë përparimtare të racionalistëve e iluministëve. Janina e Voskopoja qenë vatra të përhapjes së këtyre ideve. Në Janinë punoi për mjaft vjet Eugjen Vullgari, i cili me veprimtarinë e tij didaktike e filozofike, përhap mendimet e Leibnit, Lokut etj. Në Shqipëri arriti edhe jehona e ideve të revolucionit frëng, sidomos në krahinat bregdetare, në Shkodër, Janinë, ku erdhën edhe revolucionarë frëng”.⁵¹

⁴⁸ Ymer Jaka: *Përfaqësia e Napoleonit I në Prishtinë*. Rilindja e 1 Korrik 1977, fq. 8.

⁴⁹ *Histori e popullit shqiptar II, vep. e cit. fq. 70—76.*

⁵⁰ Jashar Rexhepagiq, *vep. e cit. fq. 70—76.*

⁵¹ Mahir Domi: *Kultura dhe letërsia shqipe në shekullin XVIII dhe në fillimin e shek. XIX*, në „Historia e letërsisë shqipe „I—II”, Prishtinë, 1970, fq. 187.

Në bibliotekën e Akademisë së Voskopojës⁵² gjinden një numër i madh librash të epokës së klasicizmit dhe iluminizmit frëng.⁵³ Siç duket, Theodor A. Kavalioti, shkrimtar dhe filozof shqiptar i kësaj kohe, është më i informuari në këtë pikëpamje. Ai është pa dyshim, njohësi dhe interpretuesi më i mirë i këtyre shkrimtarëve dhe ideve të ndryshme përparimtare frënge në Shqipërinë e kësaj kohe.⁵⁴

Megjithatë, kjo kohë ose koha e mbarimit të shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX paraqet vetëm fillimin e një interesimi dhe të kontakteve të tilla. Më vonë, e sidomos gjatë Rilindjes shqiptare, me shtimin e interesimit, edhe mundësitë dhe kontaktet bëhen edhe më të shpeshta dhe më të llojllojshme. Shumë shqiptarë të rinj që vijnë në Francë, e sidomos në Paris, për të punuar a studiuar, pasi i mbarojnë studimet dhe njihen mirë me idetë e reja si dhe me shkrimtarët a filozofët si La Fontenin, Rasinin, Kornejin, Paskalin, Volterin, Rusonë, Dideronë e të tjerë, kthehen në vendin e tyre ku, rëndon punojnë si mësimdhënës në shkollat qoftë në ato në gjuhën greke, turke ose në ato kombëtare shqiptare, që në këtë kohë hapen gjithkund nëpër Shqipëri.⁵⁵ Është me rëndësi të thuhet se edhe shkrimtarët eminentë të kësaj epoke si Çajupi, Mjedja, Konica e të tjerë kanë studiuar e punuar në Francë.⁵⁶ Këta shkrimtarë si edhe shumë të tjerë e njohin shumë mirë kulturën frënge, rrymat e ndryshme letrare dhe filozofike etj. Prandaj, nuk është vështirë të vërehet te ata ndikimi i shkrimtarëve të romantizmit frëng si i Victor Hugo-së, La Martine-it, Musset, Auguste Comte etj. Kështu ndodh që të përshtaten edhe vjersha a tregime të ndryshme nga letrësia frënge e kësaj kohe, siç është rasti me „Të varfërit” e Naimit nga vjersha homonime e Victor Hugo-së⁵⁷ ose F. Shirokës dhe Asdrenit, të cilët epigrafët e disa vjersha të tyre i marrin nga shkrimtarët si Musset, Hugo, Augier etj. Shkrimtarët në përgjithësi, si dhe shumica e elitës shqiptare, e njohin mirë edhe gjuhën frënge, gjë që u ndihmonte për t'i njohur dhe lexuar në origjinal veprat e ndryshme letrare a filozofike duke përfshirë këtu edhe fabulat e La Fontenit. Është interesant të përmendim edhe faktin se disa shkrimtarë si Çajupi, Vaso Pasha, Konica e të tjerë i shkruajnë disa nga veprat e tyre edhe në gjuhën frënge.

Gjatë kësaj kohe, në shumë shkolla që ekzistonin në Shqipëri, frëngjishtja mësohet si gjuhë e huaj. Mësimdhënësit e kësaj gjuhe

⁵² Jashar Rexhepagiq, *vep. e cit.* fq. 70—77.

⁵³ Mahir Domi: *Lëvizja kulturelle... Në: Historia e letërsisë I—II*, vep. e cit. fq. 228—229.

⁵⁴ Alfred Uçi: *T. A. Kavalioti — un représentant albanais des tu mières (XVIII^e siècle)*. Tiranë, 1966.

⁵⁵ *Nationalité albanaise*. Nates de voyage par Ferdinand van tangehove. Bruxelles (Pa datë botimi) fq. 99—114.

⁵⁶ Dhimitër Shuteriqi: *Mjedja nxënës dhe pedagog jashtë atdheut (1879—1898)*. — Në: *Nëpër shekujt letrarë*. Studime. Tiranë, 1973, fq. 346. Dhe Luan Starova: *Ballkani në prozën e Gijom Apolinerit*. Jehona nr. 4—7, 1975.

⁵⁷ Nasho Jorgaçi: *Të dhëna dhe mendime rreth novelës „Katër stinët” të Naim Frashërit*. Sesioni shkencor 1971, Tiranë, 1972, fq. 195—214.

janë, rëndom, njerëz që kanë kryer studimet a ndonjë shkollë tjetër në Francë a në vende të tjera të Evropës Perëndimore. Duke ua mësuar këtë gjuhë nxënësve të tyre, ata ua mësojnë edhe shumë gjëra nga kultura, letërsia, e sigurisht ua mësojnë edhe fabulat e La Fontenit si më të përshtatshme për fëmijë. Kur bëhet fjalë për shkollat, është interesante të përmendet një shkollë frënge nga këto vise të Ballkanit, e cila ka pasur një regjim shumë specifik. Kjo është Kolegji Frëng (Le Collège Français) „Saint-Vincent” i Manastirit i themeluar nga kleri katolik i Francës në fillim të shekullit tonë. Qëllimi kryesor i kësaj shkolle „përbëhej në përhapjen e ndikimit frëng, posaçërisht e gjuhës frënge”.⁵⁸

Më vonë, pas çlirimit të vendit, kontaktet në mes të këtyre popujve bëhen (gjë që është plotësisht e arsyeshme) edhe më të mëdha, më të shpeshta e më të llojllojshme dhe interesimi ndaj Francës dhe gjithë asaj çka është frënge bëhet edhe më i madh. Kështu, edhe gjuha frënge mbetet një nga gjuhët më të mësuara në shkollat shqiptare dhe La Fonteni, si shkrimtari më i preferuar dhe më i popullarizuar i fëmijve shqiptarë. Megjithatë, për depërtimin e disa fabulave të La Fontenit në popull, meritë të madhe kanë fabulistët si Çajupi, Naimi, Negovani e të tjerë. Pa dyshim, nëpërmjet Francës a këtyre kontakteve, te shqiptarët depërtojnë jo vetëm fabula të La Fontenit por edhe të tjera, qoftë të vendit, qoftë të jashtme.

d. Kontakte të tjera

Pa dyshim, ekzistojnë fabula a motive fabulash që kanë depërtuar te shqiptarët edhe nëpërmjet popujve të tjerë, si serbët, bullgarët, turqit e të tjerë. Në të kaluarën, qysh nga ardhja e serbëve dhe e bullgarëve në Ballkan (sh. V—VIII) këta popuj poashtu kanë qenë në kontakte të ndryshme me shqiptarët. Me arritjen e tyre ata përzihen me popullatën ilire ose shqiptare. Këta popuj po ashtu vijnë në kontakt me bizantinët dhe grekët, të cilët, si më të përparuar, luajnë një rol shumë të madh te ardhacakët e rinj. Ata hyjnë, qysh nga këto kohë, në sferën e kulturës dhe të religjionit bizantin. Më vonë, gjatë mesjetës, disa nga këta popuj arrinë ta përhapin pushtetin e tyre edhe në territoret shqiptare. Kështu, gjatë kësaj kohe, Bullgaria dy herë bëhet perandori mjaft e madhe dhe e fuqishme, duke i nënshtuar edhe shumë vise shqiptare. Edhe serbët po ashtu arrinë ta zgjerojnë pushtetin e tyre (e sidomos në kohën e Car Dushanit, 1331—1335) në viset e shumë popujve të tjerë, duke i përfshirë këtu edhe shqiptarët. Në këtë mënyrë, me dashje a pa dashje, kontaktet në mes të këtyre dy popujve dhe shqiptarëve nuk ndërpritën gati asnjëherë. Ato janë te natyrës së ndryshme: tregtare, kulturore, politike etj. Ardhja e turqve nuk i ndryshon shumë këto raporte. Ata vazhdojnë të jetojnë gati në të njëjtat kushte duke e

⁵⁸ Jashar Rexhepagiq, *vep. e cit. fq. 89.*

ndihmuar shpeshherë njëri-tjerin në përpjekjet e tyre për t'u çliruar nga zgjedha turke. Gjatë shekullit XIX dhe në vitet e para të shekullit XX këto raporte e kontakte bëhen edhe më të medha dhe të llojlojshme. Në shumë vise të banuara me shqiptarë ata hapin edhe shkolla në gjuhët e tyre të cilat, nga rrethana a shkaqe të ndryshme, i vijojnë edhe shumë nxënës shqiptarë.

Ardhja e turqve në këto anë, pranimit i islamizmit nga pjesa më e madhe e shqiptarëve, hapja e shkollave turke dhe marrëdhëniet e ndryshme në mes të këtyre dy popujve i hap rrugën edhe depërtimit të fabulave a motiveve të fabulave të popujve të ndryshëm të Azisë e të Afrikës. Kështu sot, te shqiptarët myslimanë hasim disa fabula a motive fabulash, në të shumtën e rasteve, të veshura me moralin e këtij religjioni.

Nëpërmjet këtyre kontakteve a marrëdhënieve depërtojnë te shqiptarët edhe fabula të La Fontenit. Sepse, edhe në këto vende, interesimi ndaj Francës është mjaft i madh. Sidomos kjo shprehet në shekullin XIX, e sidomos nga mbarimi i tij dhe fillimi i shekullit XX. Idetë frënge, e sidomos ato të Revolucionit tanimë gjithkund kanë depërtuar në Ballkan.⁵⁹ Në këto vende, e sidomos në qendrat e tyre, jetojnë e punojnë shumë shqiptarë. Kjo sidomos shprehet në kryeqytetin e Perandorisë turke, në Stamboll. Edhe këtu, si dhe në Shqipëri dhe në vende të tjera, bëhen përpjekje të ngjashme për të ecur drejt progresit, duke i marrë si shembull vendet e Evropës Perëndimore e sidomos Francën. Kjo është koha „kur fillojnë me depërtue idetë evropiane në Turqi, kur fillon shkollimi i turqve në Evropë, ku njihen me letërsinë evropiane, a ma mirë me thanë me letërsinë franceze”.⁶⁰ E, siç e dimë, në Stamboll jetojnë dhe punojnë, përveç të tjerëve, edhe shkrimtarët si Naimi, Samiu, Vaso Pasha, Jani Vreto e shumë të tjerë.

BIBLIOGRAFI

1. Z. Sako: *Rreth disa elementeve të përbashkëta ndërkombëtare në përrallat shqipe dhe veçoritë e tyre kombëtare*, në „Konferenca e parë e studimeve albanistike” (Tiranë, 15—21) Tiranë, 1965, fq. 315—22.
2. *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635—1912)*, vol. I—III. Tiranë, 1961—62.
3. Th. Mitko: *Bleta shqiptare*, Aleksandri, 1878.
4. S. Dine: *Valët e detit*, Sofi, 1908.
5. *Historia e letërsisë shqipe I—II*, Prishtinë, 1968.
6. *Histori e popullit shqiptar I, II*, Prishtinë, 1969.
7. A. Stipçeviq: *Ilirët*. Prishtinë, 1967.

⁵⁹ A. Dabinović: *La France révolutionnaire et les pays balkaniques*, AIFZ, viti I, nr. 2—3, Korrik-Dhjetor 1937, fq. 87—97.

⁶⁰ Hasan Kaleshi: *Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke*. „Gjurmime albanologjike” nr. 1, 1968.

8. Avianus: — *Les Fables d'Avianus, suivies de Distiques de Denys Caton*, traduction nouvelle par Julelenu. Paris, 1843.
9. Babrius. — *Fables de Babrius*, traduction en vers français par J. — F. Gail. Paris, 1846.
10. *Sur l'influence de La Fontaine en Allemagne et en Angleterre*, në „La littérature comparée” nr. 116, 1769.
11. C. Castaigne: *L'influenca del La Fontaine sui favolisti italiani del secolo XVIII*. Napoli, 1914.
12. C. Castaigne: *Trois fabulistes, Esope, Phèdre et La Fontaine*, në „Etudes philosophiques et littéraires”, Paris, 1889.
13. Chantich — Chandan (Krstić): *L'influence de la littérature française dans les Balkans*. Paris, 1940.
14. *Fables orientales et poesies diverses*. Paris, 1912.
15. *Fables turques*. Traduites par J. — Decourdemanche, Paris, 1882.
16. C. Filosa: *La Favola et la letteratura esopiana in Italia dal Medioevo ai nostri giorni*. Milano, 1952.
17. B. de Fontenelle: *De l'origine de Fables*. Ed. critique avec une introduction, des notes et un commentaire par J. — K. Carré. Paris, 1922.
18. E. Franke: *Esope, Phèdre et La Fontaine comparés*. Berlin, 1878.
19. G. Germain: *La Fontaine et les fabulistes espagnols*, në „R. Litt. comp. XII”, 1932, fq. 312—29.
20. F. Gohin: *La Fontaine et les fabulistes de son temps*, në „Muse fr.”, 1933, fq. 163—83.
21. Vojislav Ilić: *Antologija narodnih pripovedaka*. Matica srpska, Novi Sad, 1960.
22. Hervieux, L.: *Les fabulistes latins depuis le siècle d'Auguste jusqu'à la fin du Moyen âge*, 2 vol. Paris, 1894 dhe 1893—99.
23. *Les Cing fabulistes, ou les trois cents fables d'Esope, de Lockmann, de Philephe, de Gabrias et d'Avianus, ouvrage suivi des fables mythologiques dans les meilleurs écrivains de l'antiquité*. Par M. de Bellegarde. 10 édition, Paris, 1802, 2 vol.
24. Nojgaard, M.: *La Fable antique*, 2 vol. Kopenhagen, 1964.
25. *Ruskaja basna XVIII i XIX veka*. Leningrad, 1949.
26. *Fables grecques choisies, avec la traduction et les explications grammaticales des mots*. Paris, 1777.
27. Esope: — *Les Fables d'Esope, Phrygien*, avec leur sens moral et la vie de l'auteur. Par Planude. Nouvelle édition revue, corrigée et augmentée de plusieurs fables du même auteur qui ne se trouvent pas dans les précédentes impressions françaises. Genève, S. de Tournes, 1694.
28. René Bray: *Les Fables de La Fontaine*. Paris, 1929.
29. Emile Chambry: *Notice sur Esope: në „Esope: Fables.”* Paris, 1927.
30. A. Brenot: *Introduction*, në „Phèdre: Fables”, Paris, 1923.

Veli Veliu

SUR LA FABLE ET SON INTRODUCTION CHEZ LES ALBANAIS

Résumé

L'expression allégorique ou celle de la langue d'Esope a toujours été aimé par les Albanais et surtout par leurs larges masses populaires. Ainsi, bien que ce genre littéraire, dans sa forme écrite, à cause des circonstances politiques et culturelles, y apparaisse un peu en retard en comparaison avec

d'autres peuples, il y est présent, dans sa forme orale, beaucoup plus tôt et même depuis les temps les plus reculés et préhistoriques. Il y est présent et même en un nombre assez considérable. Leur source est assez diverse: d'Esoppe, de La Fontaine, des fables orientales etc. Mais il est beaucoup de fables qui ne sont que produit des Albanais eux-mêmes. Et parce que nous avons largement parlé ailleurs de ces choses-là (Gjurmime albanologjike nr. 12, 1982), cette fois nous allons essayer à expliquer le problème de l'apparition de ce genre littéraire et sa transmission chez plusieurs peuples du monde avec un accent à part chez les Albanais.

L'origine du conte et des autres genres populaires y compris la fable a toujours intéressé les savants et les critiques divers. Comme résultat d'un tel intérêt et efforts aujourd'hui existent plusieurs hypothèses d'entre lesquelles, d'après nous, trois méritent un traitement à part: migratrice, anthropologique et mythologique. Ainsi, en prenant en considération ces efforts ou ces hypothèses, la qualité de la fable pour se transmettre très facilement d'un peuple à l'autre etc. nous sommes d'avis que les sujets homogènes ou semblables des peuples divers sont, d'un côté, comme le résultat de la nature, de la psychologie et de l'intellect unique de l'homme et des conditions identiques de son développement et, de l'autre, de leur transmission d'un peuple à l'autre par les contacts divers entre les peuples. Nous avons essayé à expliquer la transmission de ces sujets ou la présence de ce genre littéraire dans plusieurs peuples du monde avec un accent à part aux contacts de ces peuples avec les Albanais ou mieux dire les contacts greco-albanais, les contacts des Albanais avec les Romains ou les Italiens, les contacts franco-albanais et d'autres.